

## **NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

***Intesa Sanpaolo Bank Albania kërkon të punësojë:  
Pozicioni: Specialist i lartë për Parandalimin e Pastrimit të Parave  
Departamenti i Përputhshmërisë Rregullative dhe  
Parandalimit të Pastrimit të Parave***

### **Përgjegjësitë:**

- Të përgatisë përshtatjen rregullative të, dhe monitorojë zbatimin e, politikave, rregulloreve të brendshme dhe procedurave operacionale, me ligjet, aktet nënligjore dhe rregulloret e Grupit Intesa Sanpaolo;
- Të kryejë vlerësimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe përgatitjen e raportimeve periodike për Bankën Mëmë dhe organet drejtuese të Bankës;
- Të monitorojë, dhe kryejë analiza mbi, transaksionet e kryera nëpërmjet bankës për identifikimin e indiceve, formave dhe zhvillimeve të rrezikut të pastrimit të parave/financimit të terrorizmit dhe marrjen e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Të kryejë investigime mbi transaksionet dhe aktivitetet e dyshimta për pastrim parash dhe financim terrorizmi;
- Të manaxhojë marrëdhëniet me Autoritetet Mbikëqyrëse në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Të organizojë dhe zhvillojë trajnimet për punonjësit e Bankës në kuadër të forcimit të njohurive mbi rregulloret e brendshme dhe procedurat e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Të ushtrojë kontrole periodike sipas metodologjisë së Grupit Intesa Sanpaolo mbi nivelin e përputhshmërisë me rregulloret dhe procedurat operacionale të Bankës;

### **Kërkesat/afësitë:**

- Diplomë Masteri në Financë, Ekonomiks, Informatikë Biznesi, Juridik me rezultate të larta;
- Minimumi 3 vjet përvojë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave (e preferueshme në institucionet financiare) ose në funksionet e kontrollit në institucionet financiare;
- Të preferueshme (por jo të detyrueshme për aplikim) çertifikime shtesë (si psh. CAMS – Specialist i Çertifikuar i Parandalimit të Pastrimit të Parave);
- Aftësi shumë të mira analitike dhe investigative;
- Aftësi shumë të mira në Paketën Microsoft Office;

- Aftësi kompjuterike dhe kërkimore;
- Aftësi të shkëlqyera për të punuar në grup;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të marrë vendime të drejta, edhe nën kushte trysnie;
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës Angleze (të folur dhe të shkruar)

Aplikantët duhet të dorëzojnë një kopje të detajuar të CV-së në gjuhën angleze

Aplikimet duhet të dorëzohen jo më vonë se data **27 Korrik 2024** pranë Burimeve Njerëzore në adresën e email-it: [recruiting@intesasanpaolobank.al](mailto:recruiting@intesasanpaolobank.al)